

**KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURINË BASHKËSI**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE  
SKENDERAJ

Nr. \_\_\_\_\_  
No. 02-112/01.00/2303/26  
Data. \_\_\_\_\_  
Data. 03.04.2026



**Komuna Skenderaj**  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/Office of the Mayor**

# PLANI I PUNËS 2026

**Mars, 2026**

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Skenderajt është organ këshillues –konsultues për çështjet e sigurisë, me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive të komunës, si bashkësive fetare ashtu edhe të komuniteteve dhe shoqërisë civile, duke marrë parasysh edhe kriteret e përfaqësimit gjinor, i cili, në bashkëpunim me policinë, shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë për bashkësitë, në të mirë të të gjithë qytetarëve të komunës. KKSB kryesohet nga Kryetari i Komunës.

Punën dhe aktivitetin e vetë e mbështet në ligjin për Policinë Nr.04/L-76, Udhëzimin Administrativ të MPB-së Nr. 27/2012 dhe Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr. 03/2012, ligjit për VQL, Statutin e Komunës si dhe akte të tjera nënligjore, ku komuna siguron kushte pune për mbajtjen e takimeve të KKSB-së.

Parimi kryesor dhe i përhershëm i KKSB-së është bashkëpunimi me të gjithë akteret të cilët ndihmojnë në çështjen e sigurisë si dhe me EVSB-të dhe KLSP-të, për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet me synim të zgjidhjes konkrete të problemeve duke përfshirë edhe ato që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi.

### QËLLIMI

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, qëllim parësor të aktiviteteve ka identifikimin trajtimin dhe adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me dukuritë negative që prekin çështjen e sigurisë publike, rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e dukurive negative, sjelljet e dhunshme si dhe parregullsitë tjera në komunitetin lokal, identifikimin e brengave lidhur me sigurinë publike, ndërtimin e besimit të ndërsjellët në mes policisë dhe qytetarëve përmes ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve në çështjen e sigurisë publike në bashkësi.

### SYNIMI

KKSB-ja synon që të arrijë në zvogëlimin e dukurive negative që rrezikojnë prishjen e sigurisë publike në komunitet, si dhe parandalimin e veprimeve që mund të kërcënojnë sigurinë në bashkësi, po ashtu krijimin e besimit dhe bashkëpunimit me të gjithë komunitetin dhe akteret relevant që ndikojnë në çështjen e sigurisë.

Në kuadër të mandatit dhe përgjegjësisë të tij Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi do të angazhohet në identifikimin e sfidave dhe çështjeve që ndikojnë në sigurinë publike në territorin e komunës. Përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve komunale, Policisë së Kosovës dhe përfaqësuesve të komunitetit, këshilli synon të kontribuoj në krijimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë qytetarët.

Gjithashtu, KKSB do të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe organizatave të ndryshme në diskutimin dhe adresimin e problemeve të sigurisë, duke promovuar transparencë, bashkëpunim dhe përgjegjësi të përbashkët në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në komunë.

# KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

## OBJEKTIVAT KRYESORE

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi gjatë vitit 2026 synon realizimin e këtyre objektivave:

- Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve komunale, Policisë së Kosovës dhe qytetarëve në trajtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë publike.
- Identifikimin dhe adresimin e dukurive negative që mund të cenojnë sigurinë dhe rendin publik në territorin e komunës.
- Rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me rolin e tyre në ruajtjen e sigurisë në komunitet.
- Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për parandalimin e veprave të kundërligjshme dhe dukurive të tjera negative.
- Promovimin e iniciativave të përbashkëta ndërmjet institucioneve dhe komunitetit për rritjen e sigurisë në nivel lokal.

## FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMIT

Gjatë vitit 2026, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi do të fokusohet në këto fusha kryesore:

- Ruajtja e rendit dhe sigurisë publike në komunitet
- Parandalimi i dhunës në familje dhe dukurive të tjera negative sociale
- Siguria në shkolla dhe mbrojtja e të rinjve nga dukuritë negative
- Siguria në komunikacionin rrugor
- Parandalimi i zjarreve dhe menaxhimi i situatave emergjente
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit

## BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Në realizimin e aktiviteteve të planifikuara, KKSB do të bashkëpunojë me:

- Policinë e Kosovës
- Drejtoritë komunale përkatëse
- Këshillat lokale të sigurisë publike
- Institucionet arsimore në territorin e komunës
- Organizatat e shoqërisë civile
- Përfaqësuesit e komuniteteve dhe qytetarët

# KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

## KALENDARI I AKTIVITETEVE/TAKIMEVE

Nr	Muaji	Çështjet	Përgjegjës
1	Mars	<ul style="list-style-type: none"><li>- Hapja e mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës;</li><li>- Miratimi i planit të punës të KKSB-së për vitin 2026;</li><li>- Diskutim mbi situatën rreth vërshimeve gjatë muajit janar dhe masat në lidhje me vërshimet eventuale;</li><li>- Diskutim mbi menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës, identifikimin e deponive ilegale dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për parandalimin e tyre;</li><li>- Diskutim mbi sigurinë në shkolla dhe çështjeve tjera të sigurisë;</li><li>- Të ndryshme.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Kryetari i Komunës</li><li>- Drejtoria e Sherbimeve Publike</li><li>- Komandanti i Stacionit Policor</li><li>- Drejtoria e Inspekcionit</li><li>- Drejtoria e Arsimit</li><li>- Këshilli i Prindërve</li></ul>
2	Maj	<ul style="list-style-type: none"><li>- Shqyrtim i situatës së sigurisë gjatë muajve të fundit;</li><li>- Diskutim mbi sigurinë në shkolla dhe rreth tyre;</li><li>- Parandalim i dhunës në familje;</li><li>- Siguria në komunikacion;</li><li>- Të ndryshme.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Kryetari i Komunës</li><li>- Këshilli i Prindërve</li><li>- Komandanti i Stacionit Policor</li><li>- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale</li></ul>

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

3	Qershor	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i situatës së sigurisë para sezonit veror;</li> <li>- Diskutim mbi parandalimin e zjarreve gjatë sezonit të verës;</li> <li>- Diskutim rreth përgatitjes për pritje të bashkatdhetarëve;</li> <li>- Siguria në komunikacion dhe masat për parandalimin e aksidenteve;</li> <li>- Diskutim rreth mbarëvajtjes së sezonës korrje-shirjeve;</li> <li>- Ruajtja e rendit dhe qetësisë publike;</li> <li>- Diskutim rreth çështjeve të sigurisë;</li> <li>- Të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryetari i komunës</li> <li>- Komandanti i Stacionit Policor</li> <li>- Drejtori i Bujqësisë</li> </ul>
4	Gusht	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raport pune për periudhën 6 mujore të KKSB-së;</li> <li>- Diskutim rreth çështjeve të sigurisë;</li> <li>- Diskutim për fillimin e vitit të ri shkollor;</li> <li>- Diskutim rreth parandalimit të dukurive negative tek të rinjtë;</li> <li>- Të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryetari i Komunës</li> <li>- Komandanti i Policisë së Kosovës</li> <li>- Drejtorja e Arsimit</li> </ul>

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

5	Tetor	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutim rreth përgatitjeve për sezonin dimëror;</li> <li>- Diskutim rreth çështjeve të sigurisë;</li> <li>- Diskutim për masat në lidhje me vërshimet eventuale;</li> <li>- Diskutim rreth çështjes së qenve endacakë;</li> <li>- Diskutim rreth dhunës në familje;</li> <li>- Të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryetari i Komunës</li> <li>- Drejtoria për Shërbime publike</li> <li>- Komandanti i Policisë së Kosovës</li> <li>- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural</li> <li>- Drejtoria e Inspektionit</li> <li>- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqeni Sociale</li> </ul>
6	Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i situatës së përgjithshme të sigurisë gjatë vitit 2026;</li> <li>- Raport mbi aktivitetet e KKSB gjatë vitit;</li> <li>- Diskutim rreth ekspozimit të mjeteve piroteknike për fundvit;</li> <li>- Diskutimi i temave të tjera të sigurisë në përgjithësi;</li> <li>- Përmbyllja e Vitit dhe rekomandimet për vitin 2027;</li> <li>- Të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryetari i Komunës</li> <li>- Komandanti i Policisë së Kosovës</li> <li>- Drejtoria e Shërbimeve Publike</li> <li>- Anëtarët e KKSB-së</li> </ul>


  
**Kryetari i Komunës**  
**Sami Lushtaku**